



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**

**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

### **Proceserbali i Dëgjimit publik për buxhetin e vitit 2022\23, në Batllavë**

Dëgjimin publik i cili u mbajtë në fshatin Batllavë për buxhetin e vitit 2022\23 e hapi Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani, duke prezantuar edhe Drejtorin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Pajtim Balaj.

Arsyeja e këtij dëgjimi publik ishte diskutimi i hapur në lidhje me buxhetin e vitit 2023.

Një lajm i mirë tregon Drejtori Osmani për buxhetin e vitit 2023 është se do të jetë 4 milion euro më i madh se vitin e kaluar, ku buxheti i përgjithshëm ka rritur vlerën 27. 406.566 euro.

Buxheti i vitit 2023 përfshinë të gjitha kategoritë: kategorinë e pagave, të mallrave, të shërbimeve, dhe kategoria e investimeve kapitale dhe ajo e subvencioneve, dhe në të gjitha këto kategori ka rritje të buxhetit.

Sa i përket kategorisë së pagave, shpjegon Drejtori Osmani se do të ketë rritje të lehtë të pagave në sektorit publik, kjo për shkak të rritjes së numrit të puntorëve. Posaqërisht në sektorin e shëndetësisë dhe në atë të arsimit.

Rritje do të ketë edhe në kategorinë e subvencioneve ku nga 960 mijë euro planifikohet të arrihet deri në 1 milionë e 600 mijë euro, ku bëhet fjalë thuajse për një dyfishim të buxhetit.

Në këtë rritje përfshihen subvencionet për bujqësinë, për arsimin, për kulturën, për shëndetësinë dhe kategori të tjera.

Poashtu sa i përket investimeve kapitale, në bazë të asaj se si e sheh korniza buxhetore janë përafërsisht 2 milionë euro më shumë, se vitin e kaluar.

Komuna e Podujevsë thotë Fatlum Osmani i ka prioritet disa sektore, siç është ai i arsimit, i shëndetësisë dhe ai i ekonomisë. Dhe poashtu theks të veçant i është kushtuar sektorit të Kulturës, me një rritje të buxhetit afër pesë fish më shumë se ai i vitit 2021.

Arsyeja e këtij takimi tregoi Drejtori i Financave ëshë diskutimi me publikun mbi qështjen e buxhetit të vitit 2023 i cili pritet të miratohet në shtator, dhe kështu e hapë edhe debatin duke ua

mundësuar banorëve të fshatit Batllavë të tregojnë sygjerimet, ankesat dhe kërkesat e tyre në lidhje me këtë buxhet.

Gjithashtu inkurajohen të gjithë pjesmarrësit që kërkesat e tyre ti drejtojnë në drejtoritë përkatëse edhe me shkrim, duke premtuar se sa të jetë e mundur ato do të inkuadrohen në buxhetin e vitiit që po vjen.

Shefki Zeqiri, banor i fshatit Gërdoc – “kërkoni që buxheti i vitit 2023 të shpërndahet në mënyrë proporcionale në të gjitha fshatërat, sepse mendon që fshati Gëroc është i diskrimuar sidomos sa i përket infrastrukturës. Shtuar këtu faktin që përmbi 25 rrugica janë të pa asfaltuara në fshat. ani pse ka pasur paraqitje të kërkesave kur është bërë planifikimi i buxhetit, por që asnjëra nga to nuk është marrë parasysh. Asfaltohet një rrugë ose dy dhe përfundonë gjithqka. Dhe apelohet që kërkesat tonë të shqyrtohen dhe jo vetëm të kryhen obligimet ligjore. Poashtu kërkesë tjetër e banorit të fshatit Gërdoc është edhe krijimi i një fushe sportive, sepse ai vend është shëndërruar në vend mbeturinash.”

Banore e fshatit Batllavë, Bahrije Dardani – “shprehet e shqetësuar për mungesën e stafit mjekësor në ambulantën e fshatit ku ajo jeton. Duke kërkuar që mjeku në fshat të jetë prezent çdo ditë pune nga ora 07:00 e mëngjesit deri në orën 15:00 në mesditë.”

Lab Berisha – “shpreh shqetësimin e tij për mungesen e shtypjes së ujit në dy lagje të fshatit Batllavë, dhe ndërrimin e gypave e sheh si alternativë për zgjedhjnë e këtij problemi.”

Banor i Batllavës – “shpreh kërkesën e tij në lidhje me buxhetin vetanak për çdo shkollë në Komunën e Podujevës, duke e arsyetuar me faktin se nëse një shkollë e ka buxhetin vetanak të përkëtuar do të mundet të veprojë më mirë dhe më me efektivitet, dhe me një kosto më të lirë.”

Drejtori i Kulturës, Përparim Balaj përgjitet banorit që kërkonte rregullimin e një fushe në fshatin Gërdoc, se për shkak që gjashtë projektet e fushave sportive për vitin e ardhshëm janë të trashëguara nga vitet e kaluara. Këtë vit ne jemi në përpjeke për të rregulluar punët që kanë mbetur nga vitet e kaluara. Për këtë arsy e për vitin e ardhshëm do të mundohemi të përfundojmë këto projekte të mbitura në gjysmë dhe shpresojmë që në vitet e tjera në vazhdim të mund të bëjmë një projekt të tillë edhe për fshatin Gërdoc.

Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Bahri Selimi, u përgjigjet pyetjeve për kanalizim dhe për ujësjellës, duke theksuar se Komuna e Podujevës ka ndarë buxhetin më të madhë ndonjëherë në këtë drejtim. Dhe kemi një bashkëpunim me ujësjellësin e Prishtinës për të zgjedhur sidomos problemin e ujërave të zeza. Komuna jonë ka ndarë mjaftueshëm buxhet për përfundimin e kolektorit të ujërave të zeza.

Sa i përket ujësjellësit vazhdon me shpjegime Drejtori Selimi, problem të tillë nuk ka vetëm fshati Batllavë por edhe në disa fshatra të tjera. Por në bashkëpunim me ujësjellësin ne veç kemi filluar me projektin e ndërrimit të gypave kryesorë që bëjnë përcjelljen e ujit fillimisht për në

qytet, dhe krahas kësaj ne do të vazhdojmë që të bejmë ndërrimin e të gjith gypave kudo që ka probleme. Në bazë të statistikave që ka nxjerrë GRU Prishtina një sasi e madhe e ujit të pijshëm humb, dhe krejt kjo është si pasojë e vjetërsisë së gypave, dhe gjithashtu si pasojë e kyqjeve ilegale në gyp. Dhe besojmë që në një afat sa më të shkurtë do të rregullohen këto probleme dhe do të kemi mjaftueshëm ujë në komunën tonë.

Drejtori Fatlum Osmani vazhdon me përgjigjen për pyetjet në lidhje infrastrukturën, duke treguar se në projekt buxhetin e vitit 2023 parashihet që të ketë investime infrastrukturore në të gjitha fshatërat e Komunës së Podujevës. Duke sqaruar se mes tri viteve në vazhdim secili fshat i komunës do të jetë i përfshirë të paktën dy herë në investime. Normalisht që buxheti nuk arrinë të përbush çdo nevojë, por do të mundohet të bëhet maksimumi në këtë drejtim. Dhe gjithashtu përmend edhe renovimin i cili po bëhet në fshatin Gërdoc.

Ndërsa sa i përket çështjes së mungesës së mjekut Drejtori Osmani thotë se ka mungesë të stafit shëndetësorë, por që në bazë të qarkores buxhetore dhe fondit që është për shëndetësi Komunës së Podujevës i është lejuar shtimi i 18 mjekëve të rinjë. Por problematikë në vete është dhe fakti se a do ti kemi 18 mjek.

Ndërsa për çështjen e shkollës Drejtori i financave spjegon se kjo qështje rregullohet në bazë të ligjit për financa publike dhe ligjit për prokurim publik. Dhe në bazë të këtyre ligjeve vendosen shtyllat për mënyrën se si duhet të menagjohen financat publike dhe si të shfrytëzohen financat publike. Sepse buxhet kesh nuk ka as në komunë, dhe gjithqka funksionon në bazë të thesarit të shtetit, dhe kontratat që bëhet për këto qëllime shkojnë përmes ligjit për prokurim publik. Buxheti në shkolla ndahet kryesisht në bazë të numrit të nxënsëve, dhe bëhet për çdo shkollë. Dhe sa i përket investimeve kapitale në këtë drejtim kemi 15 fishim të buxhetit.

Fehmi Bajraktari, Përfaqësues i fshatit Batllavë – “ shpreh pakënaqësinë e tij në qështjen e kolektorit i cili thotë se nuk është i rregulluar mirë, sepse gjysma e kanalizimeve të fshatit janë të kyqura në lum dhe jo në kolektor. ”

Enver Mehana, Drejtor shkollës “Luigj Gurakuqi” – “ shpreh kënaqësit e tijë në lidhje me fshatin e Batllavës duke thekuar dy shkollat që janë péruruar, pastaj salla e sportit poashtu edhe fillimi i qerdhes që do të bëhet. Poashtu thotë se kanalizimi e dhe asfaltimi janë probleme shumë të vogëla. ”

Drejtori Selimi i përgjigjet pyetjes për çështjen e kolektorit, duke u pajtuar me faktin se ka probleme, por në suazat e këtij projekti shton Selimi se janë paraparë edhe mngësitë të cilat kanë mbetur nga e kaluara. Poashtu thekson se do të fillojë edhe projekti për zgjerimin e rrugës, ku në të dy anët do të krijohen trotuaret për kombësorë, të cilët do të lidhen nga rruga kryesore deri tek shkolla.

Dhe me këto spjegime përfundon edhe dëgjimi publik për buxhetin e vitit 2023 në fshatin Batllavë. **17 gusht, Podujevë**

